




REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO  
AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT  
AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE  
ANTI-CORRUPTION AGENCY

Dep. 2-D/DPK  
Nr. Prot. 01-2366/13  
Data 07-08-2013  
Nr. prot. 03



Republika e Kosovës  
Republika Kosova-Republic of Kosovo

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT  
AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE  
ANTI - CORRUPTION AGENCY

DATË/A:	06.08.2013
REFERENC-Ë:	AKK-D.P.
PËR/ZA/TO:	z. Gani Asllani – Anëtar i Komisionit të Konkurrencës
PËRMES/PREKO/THROUGH:	
NGA/OD/FROM:	z. Hasan Preteni – Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Opinion – Ofrimi i këshillimit profesional lidhur me Parandalimin e konflikti të interesit në ushtrimin e funksionit publik



I nderuari z.Asllani,

Në kuadër të kompetencave të Agjencisë kundër korrupsionit lidhur me konfliktin e interesit, sipas Ligjit për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik (L.P.K.I.), Agjencia; *"bënë këshillimin e zyrtarëve të lartë të veçantë, të eprorëve, të institucioneve eprorë, me kërkesën e tyre, për raste të caktuara të shfaqjes së konfliktit të interesave, dhe për çështje të etikës të lidhura me to, si dhe me regjistrimin rast për rast të interesave"*, (Neni 19, pika 1.5, e Ligjit Nr.04/L-051).

Konform kësaj pike, kur kërkohet për sqarimin e situatës konflikt interesi në ushtrimin e funksionit publik, ju me të drejtë pyetjen tuaj e keni adresuar në institucionin, gjegjesisht organin qendror kompetent – Agjencia kundër korrupsionit.

Lidhur me kërkesen tuaj, në pajtim me mandatin që kemi dhe duke u bazuar në Ligjet bazë të Agjencisë, për rastin e caktuar, kemi nxjerr këtë :

**OPINION**

Faqe 1 nga 1

Në bazë të kërkesës tuaj me numër protokoli të AKK-së DPKI-03-2246/13, do të përgjigjemi në pyetjen që ju e keni parashtruar në shkresën tuaj të datës 25.07.2013.

Së pari është me rëndësi të citojmë nenin 6 të Ligjit për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik, i cili përkufizon *çka është konflikti i interesit* ?.

Nga ky përkufizim kuptojmë, pos të tjerash, se; *“konflikti i interesit është gjendja e mos pajtimit ndërmjet detyrës publike dhe interesit privat të zyrtarit të lartë, kur ai ka interesa private të drejtëpërdrejta ose të tërthorta, personale ose pasurore, të cilat ndikojnë, ose duket sikur ndikojnë në ligjshmërinë, transparencën, objektivitetin dhe paanësinë e tij gjatë ushtrimit të funksionit publik”*.

Rasti i juaj konkret ka të bëjë më kryekput me angazhimin tuaj në mësimdhënie në kolegje private të arsimit të lartë në periudha të kohë pas kohshme, krahas funksionit tuaj publik si Anëtar i Komisionit të konkurrencës.

Ligji për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik (Nr.04/L-051) në nenin 10, me tri paragrafe ka paraparë mundësinë e angazhimit të zyrtarit të lartë në veprimtari tjera krahas funksionit të tij publik.

Konkretisht, paragrafi që lidhet me rastin tuaj, është paragrafin 2 i nenit 10 të këtij ligji, i cili shprehimisht thotë: *“Gjatë kohës së ushtrimit të funksionit publik, zyrtari i lartë mund të ushtrojë punë nga lëmi i shkencës, sportit, arsimit, kulturës dhe veprimtarisë humanitare, nëse nuk parashihet ndryshe me ligje tjera”*.

Pikërisht në këtë pikë e gjeni edhe përgjegjjen në pyetjen tuaj, që do të thotë se Ligji për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik nuk e ndalon punën në arsim, nëse kjo me ligje tjera nuk parashihet ndryshe.

**Por**, kur thuhet “nëse me ligje tjera nuk parashihet ndryshe”, atëherë këtu duhet shikuar në radhë të parë ligjin bazë të cilin autoriteti i juaj është i thirrur, kompetent dhe i obliguar ta zbatoj d.m.th. Ligjin për Mbrojtje të Konkurrencës nr.03/L-229, i cili në nenin 26, te kushtet për t’u zgjedhur Anëtar i Komisionit ka paraparë disa pika, e një ndër to (pika 3) shprehimisht thotë:

**3. “Asnjë person nuk mund të jetë Anëtar i Komisionit nëse ai/ajo:**

**3.1 ka interesa pronësore ose marrdhënje të punës ose kontraktuese me një ndërmarrje ose një shoqatë të ndërmarrjeve të themeluar në Kosovë.**

Prandaj, pikërisht kjo pikë lidhet edhe me obligimin e vet zyrtarit të lartë si dhe institucionit ku ai punon që të parandalojnë situatën e konfliktit të interesit.

Neni 8 i Ligjit për parandalimin e konfliktit të interesit në paragrafet 1 ,2 dhe 3 shprehimisht thotë:

1. Zyrtari i lartë ka për detyrë të parandalojë dhe të zgjidhë vetë brenda afatit ligjor, dhe në mënyrën më efektive të mundshme, çdo situatë të konfliktit të tij të interesit.



2. Në rast se zyrtari i lartë është në dyshime për ekzistencën apo jo të një konflikti interesi të lidhur me të, ai duhet të këshillohet sa më parë me udhëheqësin e drejtpërdrejtë apo organin udhëheqës.

3. Çdo udhëheqës dhe institucion udhëheqës duhet të marrë të gjitha masat e nevojshme për të parandaluar dhe zgjidhur rastet e konfliktit të interesit.

Po ashtu Ligji për Parandalimin e konflikti të interesit në ushtrimin e funksionit publik në nenin 13 paragrafi 1 thotë: *"Çdo zyrtar i lartë gjatë ushtrimit të funksionit të tij publik, në bazë të njohurive të tij dhe në mirëbesim, detyrohet që të bëjë vet deklarinimin paraprak, rast për rast, të ekzistencës së interesit të tij private lidhur me vendimmarrjen në një çështje të caktuar, që mund të bëhen shkak për lindjen e një konflikti të interesit".*

Me respekt,

